



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Asocijacija Kosovskih Opština
Association of Kosovo Municipalities

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Buletini

Publikim
dymujor
Viti XI
Nr.68
Shtator - Tetor
2014

PAS LOBIMIT NGA AKK

Qeveria do të ndaj buxhet shtesë për komunat për 3.5% të sigurimeve shëndetësore

Pas zvogëlimit të buxhetit tek kategoria Paga edhe Mëditje, lidhur me pagesën e sigurimeve shëndetësore prej 3.5 % Asociacioni i Komunave të Kosovës e mori me shumë shqetësim këtë çështje dhe menjëherë filloj takimet dhe lobimin që t'iu dilet në ndihmë komunave në këtë drejtim.

Për këtë qëllim udhëheqja e Asociacionit të Komunave të Kosovës nisi lobimin dhe takimet me përfaqësues të institucioneve qendrore. Pas takimit që delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës, kryesuar nga kryetari z.Naim Ismajli pati me ministrin e Ministrisë së Financave z. Besim Beqaj dhe stafin e tij, është arritur marrëveshja që shuma e përcaktuar për ndarje prej 3.5 % për sigurimet shëndetësore të mbulohen me buxhet shtesë nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Prandaj, Komunat gjatë përpilimit të buxheteve për vitin 2015 të cilat do të miratohen në Kuvendet Komunale nuk kanë nevojë të planifikojnë për një shpenzim të tillë.

Bordi i AKK-së dhe KEDS-i dakordohen për bashkëpunim në projektet e ndërsjella



Udhëheqja e AKK-së vizitoi komunat

Këshilli i Kryetarëve debatoi për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronave komunale si dhe për partneritetin publiko-privat

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi takimin e përbashkët të Këshillit të Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës e ku morën pjesë edhe z.Besnik Osmani – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), z.Lorik Fezjullahu – Udhëheqës i Departamentit Qendror i Partneritetit Publiko Privat në Ministrinë e Financave dhe z. Agron Maxhuni – Drejtor i Departamentit Ligjor të MAPL-së.



Në takimin e Këshillit të Kryetarëve u debatua për format dhe mënyrën e implementimit të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Ligjit për Partneritetin Publiko – Privat, si dhe për gjetjen e zgjedhjeve të përbashkët mes komunave lidhur me qentë endacak. *(vazhdon fq.3)*



Mbledhja e Bordit të AKK-së

Bordi i AKK-së mbajti takimin e rradhës në përbërje: kryetari z. Naim Ismajli, nënkryetari i AKK-së, z. Agim Veliu dhe anëtarët e Bordit, z. Bajram Mulaku, z. Muharrem Sfarqa, z. Agron Kuçi dhe z. Gradimir Mikiç. Në këtë takim ishin prezent edhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së, z. Sazan Ibrahim, si dhe z. Markus Baechler-Drejtor i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC), z. Kai Hofmann-Udhëheqës i Programit të GIZ-it “Shërbimet e Qëndrueshme Komunale”, znj. Saranda Cana – SDC – Programi për Pushtet Lokal, znj. Ardiana Efendija – nga Programi i Ujit në SDC si dhe z. Ertan Munoglu – Programi i DEMOS / HELVETAS.

Takimin e hapi dhe e kryesoi kryetari z. Naim Ismajli ku në mënyrë të veçantë falënderoi përfaqësuesit e organizatave partnere për bashkëpunimin gjatë projekteve të kaluara dhe të tashme në mbështetje të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Kolegjiumeve Profesionale në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët.

Kryetari paraqiti para anëtarëve të Bordit rendin e ditës e i cili u miratua nga të pranishmit: Prezantimi i projekteve rreth bashkëpunimit me AKK-në (z. Markus Baechler – Drejtor i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim (SDC), z. Kai Hofmann – Udhëheqës i Programit të GIZ-it – “Shërbimet e Qëndrueshme Komunale”, – znj. Saranda Cana – SDC – Programi për Pushtet Lokal, znj. Ardiana Efendija – nga Programi i Ujit në SDC (program rreth 18 milion franga) dhe z. Norbert Pijls – Programi i DEMOS / HELVETAS (program rreth 9 milion euro për qeverisje lokale), pastaj paraqitja e Raportit gjashtë mujor të Punës së AKK-së, aktivitetet e AKK-së në gjashtë mujorin e ardhshëm.

Në pikën e dytë të rendit të ditës përfaqësuesit e organizatave partnere prezantuan para Bordit projektet dhe format e bashkëpunimit së bashku me AKK-në si dhe fushat se ku mund të përfitojnë komunat në përmirësimin e shërbimeve në të

mirë të qytetarëve.

Bordi në këtë takim në pikën tjetër të rendit të ditës miratoi Raportin gjashtë Mujor të Punës të AKK-së si dhe u njoftua edhe me aktivitetet e planifikuara në pjesën e dytë të vitit.

Gjithashtu u diskutua edhe çështja lidhur me pagesën e anëtarësisë së komunave për gjysmën e vitit 2014, ku me këtë rast Bordi inkurajoi komunat të vazhdojnë pagesën e anëtarësisë edhe për pjesën e dytë të vitit.

Po ashtu anëtarët e Bordit të Asociacionit të Komunave të Kosovës debatuan lidhur me vazhdimin dhe format e bashkëpunimit me Komisionin Evropian sa i përket Agjencioneve për Zhvillim Rajonal, ku kjo çështje pritet të diskutohet edhe në takimin e ardhshëm të Këshillit të Kryetarëve.

Si shqetësim i vazhdueshëm nga ana e Bordit mbetet çështja e instalimit të njehsorëve elektrik në hapësira publike komunale nga KEDS-i si shkelje e sigurisë publike, çrregullimeve urbanistike dhe pamjes së keqe vizuale të njehsorëve andaj edhe u kërkua mbajtja e një takimi urgjent në mes të AKK-së dhe KEDS-it lidhur me këtë problematikë pasi ky proces po zhvillohet pa pëlqimin paraprak të autoriteteve respektive komunale.



(vazhdon nga ballina)

Takimin e hapë dhe e kryesoi z.Naim Ismajli – Kryetar i AKK-së i cili paraqiti sfidat dhe pengesat me të cilat po ballafaqohen komunat e Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin në praktikë të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Ligjit për Partneritetin Publiko – Privat. Poashtu z.Sazan Ibrahimiri – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së paraqiti brengat konkrete të komunave në këtë çështje dhe nëvojë për adresimin e tyre. Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së z.Besnik Osmani dhe z.Agron Maxhuni – Drejtor i Departamentit Ligjor të MAPL-së pasqyruan detajisht aspektet dhe format e përgjithshme të Ligjit dhe mënyrat për zbatimin e tyre nga ana e komunave. Udhëheqësi i Departamentit

Këshilli i Kryetarëve debatoi për shfrytëzimin dhe këmbimin e pronave komunale si dhe për partneritetin publiko-privat

Qendror i Partneritetit Publiko Privat në Ministrinë e Financave z.Lorik Fezjullahu paraqiti në anën tjetër Ligjin për Partneritetin Publiko – Privat, në kontekst të së drejtës së komunës, detyrimeve dhe përfitimeve për interes publik komunal në rradhë të parë. Kryetari i Komunës së Prishtinës, z.Shpënd Ahmeti, i cili edhe propozoi në rend të ditës çështjen për gjetjen e zgjedhjeve të përbashkët mes komunave lidhur me qentë endacak, elaboroi problemin dhe kërkoi një zgjidhje të për-

bashkët mes komunave, ku ofroi edhe një Rregullore model nga komuna e Prishtinës. Gjatë debatit lidhur me këto dy ligjet, Kryetarët e komunave paraqiten në këtë rast vërejtjet e tyre duke elaboruar sfidat dhe pengesat praktike në zbatimin e tyre. Përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe kryetarët e komunave në pjesën e rekomandimeve dhe konkluzioneve të takimit u zotuan në angazhimin të përbashkët në zbatim sa më efikas dhe praktik të akteve ligjore në çështjet e debatuar.

AKK dhe MAPL mbajnë mbledhje të përbashkët me kryetarët e komunave

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) organizuan takimin e përbashkët me kryetarët e komunave. Në këtë takim u debatua lidhur me koordinimin e aktiviteteve në mes të nivelit qendror dhe lokal për obligimet e komunave që dalin nga raportu II i Komisionit Evropian mbi Progresin e arritur në përmbushjen e kërkesave të Udhëzuesit për Liberalizimin e Vizave me Kosovën, Planin e Veprimit për Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit dhe implementimi i kërkesave për harmonizim të ligjshmerisë të akteve të adresuara nga MAPL dhe Komisionet Sektoriale, si dhe ecuria e zbatimit të projekteve të financuara nga MAPL. Në këtë takim



fjalën hyrëse e mbajti z. Naim Ismajli, Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës. Poashtu për pika të veçanta në këtë takim elaboruan edhe z.Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së dhe z.Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë.



Delegacioni i AKK-së mori pjesë në punimet e Kongresit të Pushtetit Lokal të Këshillit të Evropës

Me ftesë të Këshillit të Evropës në Strasbourg, delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës i përbërë nga kryetari z.Naim Ismajli, anëtari i Bordit z.Agim Veliu si dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi nga data 14-16 tetor 2014 morën pjesë në punimet e sesionit të Kongresit të Pushtetit Lokal. Ky është sesioni i 27-të i punimeve të këtij kongresi, ku tema kryesore e këtij sesioni do të jetë: Fuqizimi i rinisë, përgjegjësi e ndarë për qytete dhe rajone. Gjithashtu, gjatë këtij sesioni është zgjedhur edhe Kryetari i Kongresit të Pushtetit Lokal të Këshillit të Evropës me seli në Strasbourg.

Një ndër pjesët kryesore të këtij sesioni ishin edhe raportet e përgatitura nga Këshilli i Evropës për monitorimin e zgjedhjeve lokale në shtetet si: Holanda, Ukraina dhe Gjeorgjia. Në pjesën e dytë të këtij sesioni u diskutua për tensionet në Ukrainë si dhe zhvillimi i demokracisë lokale dhe rajonale në shtetet e Evropës siç është Belgjika. Delegacioni i AKK-së gjatë këtyre ditëve u takua edhe me delegacione të shteteve tjera nga rajoni dhe Evropa, ku do të bisedohet për sfidat e pushtetit lokal si dhe avancimi i demokracisë lokale në vendin tonë.

Kosova përfiton nga projekti rajonal për Eficiencë të Energjisë

Asociacioni i Komunave të Kosovës, si përfaqësues i Kosovës, do të jetë përfitues i projektit rajonal të GIZ/Fondit për Zhvillim Rajonal për Eficiencë të Energjisë. Vlera e projektit është 450.000 euro dhe ai do të zgjasë 18 muaj. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është ngritja e kapacitetit të Asociacionit të Komunave rreth përkrahjes së komunave në Eficiencë të Energjisë. Projekti ka katër komponente, ku komponenta e parë është zhvillimi i udhëzuesit për krijimin, implementimin dhe ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunal në implementimin e politikave për Eficiencë të Energjisë. Derisa komponenta e dytë ka të bëjë me shkëmbimin e përvojave të komunave të Kosovës me ato në rajon sa i përket Eficiencës së Energjisë, komponenta e tretë do të bëjë investime në një projekt kapital komunal që ka të bëjë me Eficiencën e Energjisë dhe komponenta e katërt me përkrahjen e mëtutjeshme e bashkëpunimit të AKK dhe nivelit qendror.

Pra Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) si përfaqësuese e vetme e pushtetit lokal në Republikën e Kosovës si dhe herave tjera, në vazhdimësi është duke avokuar për sjelljen e investimeve të jashtme në komunat e Kosovës.



Në foto. z.Johannes Elle – Udhëheqës i sektorit për Eficiencë të Energjisë në kuadër të GIZ/Fondi për Zhvillim Rajonal dhe z.Sazan Ibrahimimi – Drejtor Ekzekutiv i AKK-së.

Komunat kampion në përmirësimin e të hyrave vetanake

Në kuadër të aktivitetit për “Të hyrat vetanake”, me procedurë konkurruese janë përzgjedhur gjashtë komuna për t’u përcaktuar si kampione në përmirësimin e të hyrave vetanake.

Komunat e përzgjedhura janë: Gjakova, Prishtina, Peja, Lipjani, Suhareka dhe Shtërpce.

Projekti i financuar nga BE “Mbështetje për Ministrinë e Financave” po ofron mbështetje teknike për Qeverinë dhe Komunat, midis tjerash, në fushën e Decentralizimit Fiskal.

Ky projekt do t’u ofrojë komunave mundësi të veçantë në adresimin e të gjitha çështjeve që ndërlidhen me të hyrat vetanake, me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendorë.

Kryetarët e gjashtë komunave të përzgjedhura do të ftohen të nënshkruajnë një memorandum mirëkuptimi për procesin e bashkëpunimit dhe planin e punës mbi të cilin janë pajtuar. Ky aktivitet do të implementohet në bashkëpunim të ngushtë me Asociacionin e Komunave të Kosovës.

AKK-ja dhe OEK-u nënshkruan Memorandum të Bashkëpunimit

OEK-u dhe AKK-ja, lidhin këtë Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit punën e përbashkët në ngritjen e Zhvillimit Ekonomik të Komunave, zhvillimin e bizneseve mbi parimet e tregut të hapur dhe konkurrencës së lirë, zhvillimin e politikave të një sistemi financiar stabil, ngritjen e vetëdijes për miratimin e obligimeve komunale nga ana e komunitetit të bizneseve, hartimin e analizave ekonomike dhe hulumtimeve në sferën e zhvillimit ekonomik komunal, komunitetit të bizneseve dhe ngritjen e kapaciteteve humane të Komunave, angazhimi në projekte të ndryshme e të veçanta për shërbime të ndryshme për komunat dhe komunitetin e biznesit.

Palët u zotuan në implementimin e plotë të këtij memorandumimi në të mirë në bizneseve



“Ngritja e nivelit të bashkëpunimit në mes të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), si pikësynim në përkrahjen e Zhvillimit Ekonomik të Komunave të Kosovës dhe zhvillimin e komunitetit të biznesit kosovar, duke mundësuar krijimin e një ambienti më të volitshëm për biznese dhe zhvillim ekonomik” – është preambula e Memorandumit të Bashkëpunimit që u arrit mes Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) dhe Odës Ekonomike të Kosovës (OEK).

dhe komunave për një klimë biznesore që mund të sjellë një zhvillim ekonomik në vendin tonë. Memorandumi i

Bashkëpunimit u nënshkrua me 3 tetor 2014 nga kryetari i AKK-së z.Naim Ismajli dhe kryetari i OEK-ut z. Safet Gërxxhalii.

AKK dhe AKT/USAID takohen për bashkëpunim në nivelin lokal

Përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe i Programit të USAID-it ‘Avancojme Kosovën së Bashku’ (Advancing Kosovo Together-AKT) u takuan sot për të bashkërenduar aktivitetet në komunat e Kosovës.

Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Sazan Ibrahim i dhe Udhëheqësi i Programit të USAID-it ‘Avancojme Kosovën së Bashku’ (Advancing Kosovo Together-AKT) z.Reginald Todd biseduan për format dhe mënyrat e bashkëpunimit mes këtyre dy organizatave në përmirësimin e shërbimeve të ndryshme të komunave.

Të dy palët u dakorduan për lobimin për interesa të komu-



nave të Kosovës, përmirësimin e komunikimit mes qytetarëve të

komunave edhe përmes projekteve infrastrukturore, pastaj përmirësimin e mundësive ekonomike në komuna përmes trajnimeve dhe hulumtimit të tregut për grante në biznese të vogla.

Poashtu përfaqësuesit e AKK-së dhe AKT/USAID biseduan për mënyrat e rritjes së efikasitetit dhe kapaciteteve të autoriteteve lokale për t’iu përgjigjur nevojave të qytetarëve përmes trajnimeve dhe asistencës teknike në fushën e menaxhimit financiar dhe atë të planifikimit.

Programi AKT i USAID-së do të punojnë në periudhën trevjeçare në 16 komuna të Kosovës dhe do mbuloj një zonë me mbi 600.000 banorë të komuniteteve të ndryshme.

Bordi i AKK-së dhe KEDS-i dakordohen për bashkëpunim në projektet e ndërsjella

Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), në përbërjen e kryetarit z. Naim Ismajli, nënkryetarit të AKK-së z. Agim Veliu e anëtarit z. Bajram Mulaku si dhe Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së, z. Sazan Ibrahim, mbajti takim të përbashkët me delegacionin e Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) në përbërje të z. George z. Karagutoff - Drejtor Kryesor Financiar, z. Alper Erbas - Drejtor i Furnizimit, si dhe Mehmet Koç - Drejtor Ekzekutiv i Rrjetit.

Ky takim është organizuar me kërkesën e Bordit të AKK-së lidhur me shqetësimin e përgjithshëm të kryetarëve të komunave sa i përket instalimit të njehsorëve elektrik në hapësirat publike komunale nga KEDS-i papëlqimin paraprak të autoriteteve respektive komunale.

Në këtë takim, në fjalën e tij z. Naim Ismajli shprehur falënderimin për takimin dhe përgjigjen e shpejtë në kërkesën e adresuar nga AKK-ja, po ashtu theksoi se kryetarët nuk janë kundër projekteve të reja të planifikuara nga KEDS-i, por kërkoj angazhimin e dyja palëve për bashkëpunim dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta lidhur me shqetësimet e ngritura nga ana e kryetarëve të komunave.

Si kërkesë kryesore ishte instalimi i njehsorëve elektrik në respektim të planeve rregulluese urbane si dhe konsultimet në mes të dyja palëve sa i përket vendosjes së shtyllave dhe lokacionit të njehsorëve elektrik sipas parametrave të caktuara me theks të veçantë për sigurinë e qytetarëve.



Po ashtu u ngritën dhe u diskutuan edhe çështje të tjera veçanërisht përmirësimin të infrastrukturës komunale lidhur me instalimet elektrike, burokracinë në zbatimin e projekteve të përbashkëta infrastrukturore si dhe rastet e shkëputjes pa paralajmërim të energjisë elektrike në institucionet publike komunale.

Pas debatit për aspekte të ndryshme në zgjidhjen e çështjeve të ngritura, palët ranë dakord në vazhdimin e konsultimeve të mëtutjeshme dhe tejkallimin e pengesave duke u bazuar në këto rekomandime: - Të ketë një Memorandum Bashkëpunimi në mes të AKK-së dhe KEDS-it; - Komunitat të jenë partner me interes të veçantë (sa i përket çkyçjes kolektive); - Bashkëpunimi dhe eliminimi i burokracive në mes të Komunave dhe KEDS-it; - Formimi i grupeve të punës në mes të KEDS-it dhe Kolegjiut të Shërbimeve Publike dhe Planifikimit Hapësinor në përcaktimin e standardeve dhe gjetjen e hapësirave publike për vendosjen e njehsorëve elektrik në respekt të planit urbanistik komunal dhe - KEDS-i të bëjë dallimin e qartë sa i përket zonave rurale dhe urbane në vendosjen e njehsorëve elektrik.

Angazhim në implementimin e Strategjisë së Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale



Është mbajtur takimi i radhës së Kolegjiut të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Në këtë takim ishin të pranishëm anëtarët e Kolegjiut / Drejtorë Komunal të Shëndetësisë dhe

Mirëqenies Sociale, Drejtor të pesë Qendrave të Mjekësisë Familjare, përfaqësues të projektit nga Organizata Humanitare "Amici dei Bambini" si dhe stafi i Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Qëllimi i këtij takimi ishte vazhdimësia e implementimit të Strategjisë së Kolegjiut për vitin 2014-2016, duke u fokusuar në zhvillimin hapave të më tutjeshëm të kategorive sociale dhe shëndetësore si: strehimi familjar - kontraktimi i psikologëve, parandalimi i punës së fëmijëve/ funksionalizimi i Komiteteve Lokale të Veprimit, si dhe aprovimi i pesë Draft-Rregulloreve për Fuqizimin e Konceptit të Mjekësisë Familjare në komunitet.

Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave

Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave mbajti takimin e radhës për diskutim të çështjeve të cilat janë paraparë me plan të punës, si dhe çështjeve të cilat janë paraqitur si nevojë e kohës. Në këtë takim u paraqit përmbledhja dhe diskutimi i 'Komentarit' lidhur me zbatimin e dispozitave të Ligjit dhe aktit nënligjor që rregullon procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Asociacioni i Komunave të Kosovës përmes organeve të veta hartoi 'Komentarin' me qëllimin e vetëm ofrimin ndihmës për organet komunale: Kuvendit, Kryetarit të Komunës dhe organeve të administratës së Komunës në zbatimin sa më efikas dhe të plotë të Ligjit nr. 04/L - 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës. Ky dokument poashtu do të ju shërbej edhe individëve dhe subjekteve të tjera të cilat kanë interes që të zhvillojnë procedurën për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve Komunale konsideroi 'Komentarin' si shumë pozitiv dhe të nevojshëm për komunat, sikurse janë: parimet e



dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, propozimit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, formimit të Komisionit për vlerësimin e ofertave, miratimit të vendimeve, kërkesës për kthimin e pronës së komunës, procedurës së këmbimit të pronës, të zhvilluar nga AKP-ja dhe të drejtës në ankesë.

Si përfundim u kërkua nga të gjithë Kryesuesit e Kuvendeve që të këshillohen ngushtë me Zyrtarët Ligjor në komunat përkatëse në sqarimin e paqartësive të mundshme sa i përket këtyre procedurave.

Po ashtu Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave kërkoi vazhdimin e konsultimeve dhe parashtrimin e kërkesës përmes strukturave të Asociacionit të Komunave të Kosovës së bashku me Ministrinë e linjës lidhur me sqarimin e pozitës dhe adresimin e kërkesës së mëhershme për rritje të pagesës së këshilltarëve komunal.

Mos e ndot VENDIN tuaj

Me rastin e 15 vjetorit të bashkëpunimit të shtetit gjerman dhe kontributin e GIZ në Kosovë, Projekti GIZ "Modernizimi i Shërbimeve Komunale" ka hartuar dhe zbatuar projektin "Mos e ndot VENDIN tuaj" ku Asociacioni i Komunave të Kosovës ka qenë një nga bashkë-organizatorët. Gjatë këtyre ditëve janë zhvilluar disa aktivitete edukative, artistike dhe promovuese në sheshin Nëna Terezë në Prishtinë, me qëllim edukimin dhe mbrojtjen e mjedisit.


Shkurtimisht

- Përfaqësuesit e AKK-së, morën pjesë në takim për koncept-dokumentin për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën.
- Të gjitha Kolegjiumet e AKK-së janë duke mbajtur serinë tjetër të takimeve për zbatimin e planeve të tyre, poashtu ka filluar procesi i hartimit edhe të tri Strategjive të Kolegjiumeve.
- AKK-ja ka një anëtar në Forumin e Sigurisë, i cili forum këto ditë do të publikojë spotin televiziv për vetëdijësimin e pjesëmarrësve në rrugë.
- Përfaqësuesit e AKK-së ka marrë pjesë në punëtorinë e parë konsultativ për zhvillimin e strategjisë komunale për shërbime sociale profesionale për Komunën e Prishtinës.
- Përfaqësuesi i AKK-së ishte anëtarë në grupin punues për hartimin e dokumentit "Integrimi Gjinnor në Planifikim Hapësinor: Një qasje 'Hap pas Hapi' për komuna", i cili dokument është në diskutim publik pastaj do të miratohet.



Udhëheqja e AKK-së vizitoi komunat

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Naim Ismajli i shoqëruar edhe nga Drejtori Ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahimimi po vazhdojnë vizitat nëpër komuna.



Këto vizita bëhen me qëllim të koordinimit të agjendës së veprimit lidhur me mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të komunave në mënyrë sa më të mirë të mundshme.



Kryetari Ismajli dhe Drejtori Ibrahimimi kanë vizituar kryetarin e komunës së Prizrenit z.Ramadan Muja, kryetarin e komunës së Suharekës z.Sali Asllani, kryetarin e komunës së Dragashit z.Salim Jonuzi, kryetaren e komunës së Gjakovës znj.Mimoza Kusari – Lila, kryetarin e komunës së Pejës z.Gazmend Muhaxheri dhe kryetarin e komunës së Deçanit z.Rasim Selmanaj.



Edhe në këto takime është biseduar për projektligjet aktuale të cilat Asociacioni i Komunave të Kosovës po lobon për interesa të komunave të Republikës së Kosovës dhe çështjet tjera me rëndësi për qeverisjen lokale.



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS BULETINI

Viti XI. Nr. 68 • Shtator - Tetor 2014

PËRGATITI:

Arsim Osmani - MENAXHER PËR KOMUNIKIM

Tel: 038 245-734; Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës. Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore), anëtar i Rrjetit LOGIN, anëtar i Rrjetit LOGON. Anëtar në pozitën Asociacioni i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR) si dhe anëtar në ALDA (Asociacioni i Agjensive për Demokraci Lokale).

